

STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Albania Rent Car Company” SHPK

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia

Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 09.02.2022, une ortaku i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emrin “Albania Rent Car Company SHPK, formuloj Statutin e saj, si më poshtë vijon ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Ortakët e shoqërisë janë:

1. **Erion Guri** shtetas shqiptar, lindur ne Çorovode i datëlindjes 19.09.1984, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti I40919188H

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

Dhenie me qira te automjeteve te ndryshme tek individë apo biznese te tjera.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Lagjja 8, Rruga Aleksander Goga, Objekt ne Zonen Kadastrale 8512, Nr. Pasurie 5/256, Durres.

Shoqëria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithë territorin shqiptar dhe jashte vendit.

Kreu II

Neni 5:

Kapitali themeltar

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Erion Guri është zotërues i 1 kuote, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 900.000 leke.

Neni 6

KAPITALI I SHOQERISE



Kapitali aktual i shoqërisë është 900,000 lekë. Ky kapital është kontribut i ortakut Z. Erion Guri në vlerën 100%. Kuotat e kapitalit regjistrohen në librat e llogarive të shoqërisë.

Neni 7

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve e pasardhësve. Në rast vdekje të ortakëve, pjesa e kapitalit, që disponojnë i kalojnë trashëgimtarëve të tyre dhe kur asnjëri nga pjesëtarët e familjes nuk pranojnë të punojnë në ortakëri, atëherë u jepen të gjitha fitimet që u takojnë, sipas kontributit të derdhur në kapitalin themeltar. Të gjitha pjesët e kapitalit të shoqërisë mund t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmonë me vendim të asamblesë së ortakëve dhe me akt-noterial. Trashëgimtari hyn në shoqëri me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ortakut.

Neni 8

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe mjete të tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektivit të caktuar në këtë statut.

Neni 9

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga ortakët. Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqëria është e detyruar të shlyej të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

Neni 10

Shoqëria është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë të drejta të tjera materiale e jo materiale, duke përfshirë të drejtën për shitjen e pasurisë së vetë tek të tretët.

Neni 11

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Organi vendimtar i shoqërisë është asambleja e ortakëve. Ata vendosin për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorit, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuidatorëve, miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore, ndarja e fitimit, ndryshimet në statut, zvogëlimin ose zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatje të afatit të veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i shoqërisë në një formë tjetër, sipas ligjit, ndryshimi i vendndodhjes së selisë dhe të çdo çështje tjetër, që njihet brenda kufijve të ligjit ose në këtë statut.


Neni 12

Asambleja e ortakëve mbledhjet e zakonshme i bën çdo vit, brenda 3 muajve nga mbyllja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë

Neni 13

ADMINISTRATORI

Administratori i shoqërisë është z. **Erion Guri**. Administratori qëndron në detyrë për afat 5-vjeçar. Mandati i tij mund të jetë i rinovueshëm. Ortaku gëzon të drejtën që të kryejë vetë edhe detyrën e administratorit ose të emërojë, shkarkojë në çdo kohë një person tjetër në atë detyrë.



Neni 20

Largimi nga puna bëhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkelje disiplinore ose me vetë kërkesën e të interesuarit. Largimi nga shoqëria bëhet mbasi janë shlyer të gjitha detyrimet materiale e monetare.

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga asambleja e ortakëve themelues.

Neni 21

Shoqëria mund të lidhë kontrata me sektorë shtetërorë, drejtpërdrejt në tregun e lirë, si dhe persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj. Në veprimet kontraktuale, brënda dhe jashtë vendit, shoqëria përfaqësohet nga asambleja e ortakëve, ose nga një person tjetër i autorizuar prej saj. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë.

Neni 22

DISPOZITA TË TJERA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria mund të priset para afatit të përcaktuar në këtë statut, në rastet kur ndryshon afati, ose kur ka një prishje të parakohshme për shkaqe të tjera.

Neni 23

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një ose disa likuidatorë, të cilët ndjekin operacionet e likuidimit deri në fund dhe i paraqesin asamblesë së ortakëve dhe administratorit rezultatet përfundimtare të likuidimit. Në përfundim, asambleja e ortakëve vendos heqjen e mandatit të tyre. Asambleja e ortakëve merr përsipër për t'i shlyer me kapitalin e tyre të gjitha detyrimet që dalin nga likuidimi.

Neni 24

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, kur nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga gjykata.

Neni 25

Ndryshimi i shoqërisë në një shoqëri tjetër bëhet me një vendim të asamblesë së ortakëve, kur plotësohen kushtet për krijimin e shoqërisë të llojeve të tjera.

Neni 26

Themeluesi i shoqërisë mund të bëjë në çdo kohë ndryshime e plotësime në statut dhe në aktin e themelimit pa rënë ndesh në mënyrë thelbësore me nenet e përshkruara në këtë statut. Ndryshimet e plotësimet bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vetë statuti.

Neni 27



Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare nr. 9901 datë 14.4.2008. Për të gjitha çështjet e tjera të pa trajtuara në këtë statut, veprimtaria e shoqërisë do të mbështetet vetëm në legjislacionin shqiptar në fuqi, sipas rastit konkret. Referenca do të jenë ligjet e legjislacionit shqiptar në fuqi, përfshirë edhe aktet ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tyre.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

ERION GURI

ERION GURI
